



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno/Prodato Received/Delivery	10.12.2021	viti god year	
Organ /Njesia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/STK	6077/2021		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.864/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.864/2021 të datës 13.10.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë Rr. "Hyjnesha e Varoshit", në fshatin Varosh, Komuna e Ferizajt, kundër Vendimit me Nr.946/2021 të datës 23.09.2021 të Menaxheres së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.864/2021 të datës 13.10.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 16.09.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 5007/2021 të regjistruar me numër A.nr.864/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.946/2021 të datës 23.09.2021 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.10.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankueses të Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 26.10.2021 ka pranuar përgjigjën me shkrim se bashku me shkresat e bashkëlidhura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:5007/2021 të datës 13.10.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 13.10.2021 të ankueses; Vendimin me Nr.946/2021 të datës 23.09.2021 të Menaxheres së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Kërkesën e datë 01.10.2021 të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.10.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 26.10.2021; Njoftimin e datës 16.09.2021 të ankueses; Formularin e Rezultateve të Kandidatit; Gjendjen e hyrje/dalejve në punës për ankuesen për periudhën 23.09.2021 deri 25.10.2021; Raportin e ndërprerjes së përkohshme në punë të datës 25.10.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.864/2021 të datës 13.10.2021, *sepse:*

Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se me datë 16.09.2021 ankuesja i është drejtuar përmes emailit zyrtar Menaxheres se Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë se Punëve të Brendshme, duke njoftuar të njëjtën se do të jetë pjesë e procesit zgjedhor për asamble komunale, mirëpo nuk do të zhvilloje aktivitet politik me qytetar dhe do t'i përmbahet strikt rregullave ligjore për mbrojtje nga pandemia Covid 19 në Republikën e Kosovës.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë se Punëve të Brendshme, me datë 23.09.2021 ka nxjerr Vendimin Nr.946/2021 përmes të cilit ka refuzuar pezullimin e marrëdhënies se punës te ankueses, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Komonale të 17 Tetorit 2021. Refuzimi i kërkesës është bërë duke u bazuar në dispozitat e nenit 22 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitat e nenit 26 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Ankuesja, pas pranimit të këtij vendimi, me datë 01.10.2021, përmes emailit zyrtar i është drejtuar Z.v Sekretares se Përgjithshme të Ministrisë se Punëve te Brendshme, ku e ka njoftuar lidhur me refuzimin e kërkesës dhe njeherit ka kërkuar nga kjo e fundit të ndërmarr veprime për realizimin e kërkesës se saj për pezullimin e marrëdhënies se punës. Ndërsa me datë 13.10.2021 e njëjta kundër Vendimit Nr.946/2021 të datës 23.09.2021, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak te shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, dhe Vlerësimit të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke iu referuar shkresave të lëndës, ka konstatuar se objekt i kësaj ankese është trajtimi i ligjshmërisë se Vendimit Nr.946/2021 të datës 23.09.2021, gjegjësisht kërkesa për anulimin e të njëjtit me qellim të lejimit të pjesëmarrjes se ankueses në zgjedhje lokale të cilat janë mbajtur me datë 17.10.2021. Andaj, duke marr parasysh se objekti i ankesës lidhet me kërkesën për pushim pa pagesë për pjesëmarrje në zgjedhje lokale të cilat kanë përfunduar me datë 17.10.2021, dhe meqenëse ankesa nuk atakon ndonjë veprim pasues të lidhur me këtë proces, Kolegji vlerëson se objekti për të



cilin është iniciuar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë andaj vendosi për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.864/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;